



Prishtinë, 12.10.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1609_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2334_07_22** i dt.18.07.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 23.09.2022.

në seancën e mbajtur më datë 12.10.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M. M., nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2334_07_22 i dt.18.07.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 18.07.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2334_07_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 26.04.2022 lidhur me kontestimin e faturave nr.0222122DPR-120502 dhe nr.0222222DPR-120502 datë 28.02.2022 si dhe periudhën mars 2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 32600412.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, pala M. M., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi i periudhës shkurt dhe mars nuk mund të jetë real duke u bazuar në konsumin e me hershem;
- Pala kërkon nga Bordi që të shqyrtoj ankesën në kohë dhe të merr vendim të drejtë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi nr.0222122DPR-120502 dhe nr.0222222DPR-120502 datë 28.02.2022 dhe 03220DPR-120502 datë 30.03.2022 me njehsorin elektrik nr. nr. 32600412 nuk është



i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Faturat nr.0222122DPR-120502 dhe nr.0222222DPR-120502 datë 28.02.2022, 03220DPR-120502 datë 30.03.2022; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 21.03.2022; Përgjigja e KESCO-s datë 26.04.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 05.05.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2334_07_22 i dt.18.07.2022, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, gjeti se faturimi i periudhës shkurt është real. Kështu KESCO ka vepruar konform Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në shqyrtim e sipër të rastit, ZRrE ka vërejtur se, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 28.02.2022 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2022 (faturat nr.0222122DPR-120502 dhe nr.0222222DPR-120502) me **4,322.28 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **347.17€**. Me datë 21.03.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i behet ri shqyrtimi i faturave për periudhën shkurt 2022 (nr.0222122DPR-120502 dhe nr.0222222DPR-120502) për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 32600412. Me datë 26.04.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe leximeve të rregullta mujore

Bordi, ka analizuar faturat nr.0222122DPR-120502 dhe nr.0222222DPR-120502 datë 28.02.2022 të konsumatorit dhe konstaton se KESCO për faturimin e shpenzimeve të periudhës shkurt 2022 ka bërë ndarjen e shpenzimeve në dy fatura. Kjo ndarje është bërë duke marrë për bazë shpenzimin total mujor për periudhën 28.01.2022 deri në periudhën 28.02.2022, i cili pastaj është pjesëtuar me periudhën 31 ditore sa zgjat cikli mujor i shpenzimit dhe të njëjtin e ka ndarë për dy periudha. Periudha e parë e faturimit përfshin periudhën nga data 28.01.2022 deri në periudhën 08.02.2022(11 ditë) kurse periudha e dytë përfshinë periudhën 09.02.2022 deri në periudhën 28.02.2022(20 ditë). Sipas listave të leximit dhe rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimi total i konsumatorit për periudhën shkurt 2022(31 ditë) është 4,322.28 kWh(TL=2629.81 kWh dhe TU=1692.47 kWh) dhe si shpenzim ditore i konsumatorit është marrë TL= 84.83 kWh dhe TU=54.60 kWh dhe i njëjti është llogaritur për dy periudhat. Për periudhën 28.01.2022 deri me 08.02.2022 (11 ditë)është faturuar shpenzimi TL=933 kWh dhe TU=600 kWh me tarifën e vjetra kurse për periudhën 09.02.2022 deri në periudhën 28.02.2022(20 ditë)është faturuar shpenzimi TL=1696.81 kWh dhe TU=1092.71 kWh duke e ndarë shpenzimin në dy blloqe(Blloku i parë 0-800 TL=486.67 kWh dhe TU=313.33 kWh kurse blloku i dytë >800 TL=1210.14 kWh dhe TU=779.14 kWh). Bordi po ashtu ka shqyrtuar faturën e periudhës mars 2022, nr.03220DPR-120502 datë 28.03.2022 të cilën e ka kontestuar konsumatori dhe konstaton se konsumatori është faturuar bazuar në leximet e rregullt pasi që në asnjë rast lexuesi i KEDS-it nuk ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve mujore. Po ashtu bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike vërtetohet se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimeve në mes periudhës kontestuese dhe periudhave të mëhershme. Sipas rrjedhës së energjisë shpenzimet e konsumatorit në periudhën e njëjtë 02/2020 është 3,876 kWh, periudhën 03/2020 është 4,214 kWh, periudhën 02/2021 është 4,770 kWh dhe periudhën 03/2021 është 4,761 kWh.



Bazuar ne te gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: “1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit M. M., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.